



INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE

EDA BEQIRI

**PËRGJEGJËSE E SEKTORIT TË INSPEKTIMIT TË SHËNDETIT
NË PUNË**



LIGJI NR.10433 DATE 16.06.2011 “PER INSPEKTIMIN NE RSH”,

LIGJI NR.7961 DATE 12.07.1995 “KODI I PUNES I REPUBLIKES SE SHQIPERISE” I NDRYSHUAR,

LIGJI NR.9634 DATE 30.10.2006 “PER INSPEKTIMIN E PUNES”, I NDRYSHUAR,

LIGJI NR.10237 DATE 18.02.2010 “PER SIGURINE DHE SHENDETIN NE PUNE” I NDRYSHUAR, SI DHE TE GJITHA VKM-TE TE DALA NE ZBATIM TE TIJ.

GJITHASHTU ISHPSHSH KONTROLLON ZBATIMIN E LIGJIT TE NXITJES SE PUNESIMIT, LIGJIT PER TE HUAJT, LIGJIT PER MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TE DETYRUESHME TE SIGURIMEVE SHOQERORE DHE SHENDETESORE.



DISPOZITAT E LIGJIT PER SIGURINE DHE SHENDETIN NE PUNE ZBATOHEN NË TË GJITHË SEKTORËT E VEPRIMTARISË PRIVATE DHE PUBLIKE.

NUK DO TË ZBATOHEN DISPOZITA TË CAKTUARA TË KËTIJ LIGJI, KUR NË DISPOZITAT E TJERA LIGJORE PËR FUSHAT PËRKATËSE JEPEN TRAJTIME MË TË FAVORSHME PËR MBROJTJEN E SIGURISË E TË SHËNDETIT NË PUNË TË PUNËMARRËSVE.

KY LIGJ NUK DO TË ZBATOHET, KUR VEÇORITË KARAKTERISTIKE TË DISA VEPRIMTARIVE TË VEÇANTA TË SHËRBIMIT PUBLIK, SI FORCAT E ARMATOSURA, POLICIA E SHTETIT, OSE DISA VEPRIMTARI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE CIVILE, JANË NË KUNDËRSHTIM ME PËRCAKTIMET E KËTIJ LIGJI. NË KËTO RASTE SIGURIA DHE SHËNDETI NË PUNË DUHET TË SIGUROHEN SA MË SHUMË TË JETË E MUNDUR, NË PËRPUTHJE ME KËRKESAT E KËTIJ LIGJI.



SITUATA E KRIJUAR TASHME JO VETEM NE VENDIN TONE , POR NE MBARE BOTEN ME PERHAPJEN E PANDEMISE SE COVID-19, KA BERE QE QEVERIA SHQIPTARE TE MIRATOJE NJE SERE AKTESH NENLIGJORE DHE RREGULLA SHTRENGUESE ME QELLIM PARANDALIMIN E PERHAPJES SE KESAJ PANDEMIE.

ISHPSHSH-JA SI NJE INSTITUCION EKZEKUTIV I ADMINISTRATES PUBLIKE NE PERPTHJE ME TE GJITHA MASAT E MARRA NGA QEVERIA KA MIRATUAR URDHERIN PER MARRJEN E MASAVE TE VECANTA NE PARANDALIMIN E PERHAPJES SE INFEKSIONIT TE SHKAKTUAR NGA COVID-19, KU E GJITHE TRUPA INSPEKTUESE USHTROI KONTROLLE RASTESORE NE SUBJEKTET FASON, CALL-CENTER E FABRIKA TE TJERA QE U LEJUAN TE USHTROJNE AKTIVITETITN E TYRE NE PERIUDHEN E KARANTIMIT, TE CILET KANE NJE PERQENDRIM TE LARTE TE PUNONJESVE NE TE NJEJTIN AMBJENT PUNE.



FOKUSI I KETYRE INSPEKTIMEVE ISHTE VETEM VERIFIKIMI DHE RESPEKTIMI I MASAVE TE MARRA NGA SUBJEKTET SIPAS UDHEZIMEVE TE OBSH DHE MINISTRISE SE SHENDETESISE, SI:

DEZINFEKTIMI I AMBJENTIT DHE DEZINFEKTIMI I CDO PORTE HYRESE TE GODINES.

RESPEKTIMI I DISTANCES SE SIGURISE SE PUNONJESVE 1,5-2M.

REDUKTIMIN E PERSONELIT NE SUBJEKTET CALL-CENTER PER TE MUNDËSUAR RESPEKTIMIN E DISTANCES SE SIGURISE.

MASAT HIGJENO-SANITARE PER CDO PUNONJES, PER TI AKSESUAR DHE PERDORUR LEHTESISHT.

PERDORIMI I MJETEVE MBROJTËSE INDIVIDUALE NGA TE GJITHE PUNONJESIT, VECANERISHT MASKA E DOREZA.



BAZUAR NE URDHERIN NR.266 DATE 21.04.2020 TE MINISTRES SE SHENDESESISE DHE MIREQENIES SOCIALE, UDHEZIMIT TE INSTITUTIT TE SHENDETIT PUBLIK DHE PROTOKOLLEVE TE PERCAKTUARA NGA KY I FUNDIT, ME QELLIM PARANDALIMIN E PERHAPJES SE COVID-19 NE AMBJENTET E PUNES, SIPAS PERCAKTIMIT NE PROTOKOLLIN E KUQ, TE GJITHA SUBJEKTET TE CILAT PERFSHIHEN NE KETE PROTOKOLL DUHET TE DEKLAROJNE PRANE INSPEKTORATIT SHTETEROR SHENDETESOR DHE INSPEKTORATIT SHTETEROR TE PUNES DHE SHERBIMEVE SHOQERORE GJENERALITETET DHE LICENSEN E PERSONIT PERGJEGJES PER SHENDETIN (MJEKUT TE NDERMARRJES).

DERI ME TANI PRANE ISHPSHSH-SE KANE DEKLARUAR KETO TE DHENA RRETH 400 SUBJEKTE



COVID-19: BACK TO THE WORKPLACE - ADAPTING WORKPLACES AND PROTECTING WORKERS



AGJENSIA EUROPIANE PER SIGURINE DHE SHENDETIN NE PUNE ËSHTË PËRFSHIRË THELLËSISHT, DUKE BASHKËPUNUAR ME QENDREN EUROPIANE PER KONTROLLIN DHE PARANDALIMIN E SEMUNDJEVE(ECDC) DHE KOMISIONIN EUROPIAN, NE REALIZIMIN DHE PUBLIKIMIN E UDHEZUESVE DHE ARTIKUJVE TE NDRYSEM, NE LIDHJE ME MASAT QE DUHET TE MARRIN KOMPANITE PER PARANDALIMIN E PERHAPJES SE COVID-19 NE AMBJENTET E PUNES, KU THEKSI DHE PËRQENDRIM I MADH KA QENE NË PERDORIMIN E PPE , SESA TË NDJEKË HIERARKINË E KONTROLLIT SIÇ PËRCAKTOHET NË KORNIZËN E DIREKTIVES SE AGJENTËVE BIOLOGJIKË.

GJITHASHTU SHTETET ANETARE TE BE-SE KANE HEDHUR NE KONSULTIM QE VIRUSI COVID-19 TE SHTOHET NE LISTEN E AGJENTEVE BIOLOGJIKE NE GRUPIN E TRETE OSE TE KATERT, E CILA PRITET TE MIRATOHET SE SHPEJTI.



<https://osha.europa.eu/en/tools-and-resources/oshwiki>



<https://osha.europa.eu/en/tools-and-resources/oira>